




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3992/13</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>19.11.2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.11.2013 mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3172/13, për z. *Fatmir Gashi*, zëvendës, *Gubernurator i Bankës Qendrore te Republikës se Kosovës*, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3172/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin i Lartë, z. *Fatmir Gashi*, zëvendës Gubernurator i Bankës Qendrore të Republikës se Kosovës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, zëvendës Gubernurator i Bankës Qendrore i Republikës se Kosovës, është duke ushtruar edhe funksione tjetra në veprimtari private, e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.10.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.



Pas këtyre procedurave, z. Fatmir Gashi zëvendës Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e agjencisë në takimin që është mbajtur me z.Gashi e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik.

z. Fatmir Gashi është pajtuar me faktet, mirëpo na ka njoftuar se që në momentin që mediat e kanë potencuar angazhimin e tij në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar, ka vendosur të jap dorëheqje, pasi që nuk ka pas njohuri që kjo situatë mund të paraqes konflikt të mundshëm të Interesit andaj edhe ka dhënë dorëheqje.

Gjatë takimit zyrtarët e AKK-së, kanë kërkuar nga z.Fatmir Gashi, sqarime lidhur me angazhimet e tij si person zyrtarë në disa kompani private, z. Gashi është përgjigjur duke thënë se që nga momenti që ka marrë pozitën e zyrtarit të lartë nuk mbanë asnjë funksion në biznese private.

Zyrtarët e Agjencisë i kanë paraqitur faktet z.Gashi, për gjendjen reale, ai është arsyetuar se për të gjitha këto ka dëshmi që nuk ushtron funksion mirëpo nuk janë bërë ndryshimet nga pronaret në ARBK (Agjencinë për Regjistrimit e Bizneseve), dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të kërkojë nga pronaret e bizneseve ku ka qen duke punuar me herët që të bëjnë ndryshimet, dhe mos të figuron emri i tij si person zyrtarë në këto kompani, pasi që me nuk ushtron asnjë aktivitet në biznese private të identifikuar nga AKK-ja.

Zyrtari i lartë z.Fatmir Gashi zëvendës Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me datën 08.10.2013, ka sjellë në AKK-ë, deshminë se ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuesit të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar. z.Fatmir Gashi, me datën 06.11.2013, ka sjellë në AKK-ë deshmit nga:

- Këshilli Administrativ i Byros Kosovare të Sigurimeve BKS, se nuk është me anëtar i Këshillit Administrativ që nga data 31.07.2013.
- Ndryshimet në biznesin K.S. "ILYRIA"
- Ndryshimet në biznesin Sh.p.k "MOBIKOS" si dhe
- Ndryshimet në biznesin SH.A "Dardania"

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Fatmir Gashi, zëvendës Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, pasi ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesuesit të Këshilli Kosovar për Raportim Financiar si dhe ndryshimet në bizneset ku kishte punuar me herët, ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
  
- Z./zgj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zgj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Prëteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

